

VENDIM
Nr. 104, datë 6.4.2022

**AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE “NDIHMË ME KARAKTER SOCIAL
PËR PASAGJERËT NË FLUTURIMET AJRORE”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- znj. Etleva Haka anëtare;
- znj. Mirjana Zisi anëtare;
- z. Ahmet Mançellari Anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 6.4.2022, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores ‘Për procedurat dhe formën e njoftimit’”, morri në shqyrtim planin e dhënies së ndihmës shtetërore me karakter social për pasagjerët në fluturimet ajrore.

I. Procedura

1. Në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Komisioni i Ndihmës Shtetërore shqyrtoi planin e ndihmës, lidhur me ndryshimin e udhëzimit nr. 1917, datë 1.9.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”.

II. Përshkrimi i masës

2. *Qëllimi:* Rritja e numrit të pasagjerëve që udhëtojnë nga dhe drejt Shqipërisë. Plani i ndihmës lidhet me një eliminim të tarifës së shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, në vlerën 10 euro, i cili aktualisht paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës, te shoqëritë ajrore, pavarësisht vendit apo mënyrës së shitjes së biletës.

3. *Baza ligjore e njoftimit të planit:* Plani i ndihmës shtetërore lidhet me rishikimin e udhëzimit nr. 1917, datë 1.9.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”.

4. *Dhënësi i ndihmës* është Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

5. Autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit të masës është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

6. *Përfutuesit:* Përfutues janë konsumatorët/pasagjerët e transportit ajror. Sipas MIE-s, nga skema pritet të përfitojnë rreth 4 milionë pasagjerë në vitin 2022, për të cilët do të zbatohet përjashtimi nga tarifa e shërbimit.

7. *Shtrirja territoriale:* Projekti do të zbatohet në territorin e Shqipërisë.

8. *Forma e ndihmës:* Ndihma shtetërore është në formën e eliminimit të detyrimit nga ana e shoqërive ajrore të përgjegjësisë që të arkëtojnë nëpërmjet shitjes së biletës tarifën e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe të transferimit të shumave të arkëtuara tek TIA.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

9. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson, nëse plani i ndihmës shtetërore me karakter social për pasagjerët në fluturimet ajrore përbën ndihmë shtetërore, në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, pra, nëse plani ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfutur në kushte normale të tregut.

10. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, përcakton se:

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarrja nga Republika e Shqipërisë në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore.”

11. Gjithashtu, neni 71, “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë¹, përcakton se:

“Praktikat në kundërshtim me këtë nen, vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës së aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”

12. Ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

13. Vendimi për të eliminuar tarifën e shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, në vlerën 10 euro, përbën një aktivizim të burimeve shtetërore. Eliminimi i tarifës favorizon dhe lehtëson funksionimin e shërbimeve ajrore midis Shqipërisë dhe vendeve të huaja, duke gjeneruar një kërkesë shtesë për bileta të fluturimit me avion dhe në mënyrë indirekte do të përfitojnë të gjitha kompanitë që ofrojnë shërbime të transportit ajror në tregun vendës. Kërkesa në rritje për numrin e fluturimeve do të ndikojë në tregtinë ndërkombëtare, pra masa ka efekt të kufizuar në konkurrencë, duke qenë se favorizon kompanitë që ofrojnë shërbime të transportit ajror drejt dhe nga Shqipëria. Sipas Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar rezulton se vetëm në vendin tonë aplikohet tarifa e shërbimit për kalimin me avion të kufirit, në raport me vendet e rajonit, por edhe llojeve të tjera të transportit, të përmbledhur në tabelën nr. 1, si vijon:

Tabela nr. 1: Tarifat e aplikuara në rajon

Tarifat	Tirana	Shkup	Beograd	Sarajevë	Dubrovnik	Podgoricë	Prishtina	Lubjana
Tarifa e sigurisë	4	6.5	4.5	0	5	1.75	6	4.6
Tarifa e pasagjerit	10	11.5	16.5	18	11	15	12.53	10
Tarifa e kalimit të kufirit me avion	10	0	0	0	0	0	0	0
TOTALI	24	18	21	18	16	16.75	18.53	14.6

Burimi: Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar

Sipas Asamblesë së Rajoneve Evropiane², konektiviteti është i rëndësishëm për rritjen ekonomike dhe krijimit të vendeve të reja të punës në Bashkimin Evropian. Në një kohë kur Evropa po hap tregjet globale, aeroportet rajonale luajnë një rol në zhvillimin ekonomik, duke ofruar akses më të madh, përmirësim të kohezionit dhe zhvillimin social, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë në Evropë. Komisioni Evropian vlerëson se transporti dhe infrastruktura e tij janë thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e shoqërisë. Rajonet përfitojnë nga operimi i linjave ajrore të ofruara nga operimi i aeroporteve të tyre. Lidhjet ajrore krijojnë akses rajonal dhe përfshirjen sociale, përmirësojnë pozicionimin e biznesit në atë zonë, lehtësojnë tregtinë dhe, në veçanti, mundësojnë tërheqjen e investimeve. Aeroportet rajonale përmirësojnë klimën lokale të biznesit dhe mundësitë për zhvillimin ekonomik.

Një nivel aksesi i mirë në transportin ajror, mundëson krijimin e përfitimeve për tërheqjen e kompanive dhe të punëtorëve me kualifikim të lartë. Aksesueshmëria e një rajoni përcaktohet nga dy faktorë: vendndodhja gjeografike dhe infrastruktura. Ndërsa vendndodhja gjeografike nuk mund të ndryshohet, përmirësimi i konektivitetit është një objektiv kryesor.

Sipas të dhënave të INSTAT-it:

- Në Shqipëri, hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin shkurt 2022 janë 458.951 dhe, se krahasuar me shkurtin 2021, ky tregues rezulton me një rritje 27,3 %. Në shkurt 2022, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 200.997 dhe e krahasuar me shkurtin 2021, ky numër është rritur me 27,1%. Ndërkohë, numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2021 është 5.688.649, **duke u rritur me 2,1 herë**, në krahasim me vitin 2020. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në vitin 2021, është 4.190.786, **duke u rritur 44,2 %**, krahasuar me vitin e mëparshëm.

¹ Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare”.

² Shtator 2013.

- Sipas INSTAT-it, referuar të dhënave mbi hyrjet e shtetasve të huaj në Shqipëri, sipas qëllimit të udhëtimit, 2014–2021, rezulton se mesatarisht 98.23% e të huajve vizitojnë Shqipërinë për arsye personale (pushime etj.).

- Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, shpenzimet nga turistët e huaj, në periudhën 2015–2019 kanë një rritje të ndjeshme në vlerë absolute, por edhe në raport me PBB-në, ku në vitin 2019 shpenzimet e turistëve të huaj **përbëjnë 15.1%**. Ndërkohë, në vitin 2021, ecuria e shpenzimeve është pozitive krahasuar me vitin 2020 (vit i pandemisë së COVID-19), duke **uritur në 12.4%** të PBB-së.

Sipas Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë raportohet, se gjatë vitit 2019, numri i uljeve dhe i ngritjeve në Aeroportin “Nënë Tereza” ka qenë 28,270 fluturime dhe gjatë vitit 2021 ishin 26,152 fluturime. Fillimi i vitit 2022 rezulton me një rritje të trafikut, duke tejkaluar numrin e fluturimeve për të njëjtën periudhë të vitit 2019. Gjatë vitit 2022 pritet që rritja e trafikut të fluturimeve të jetë rreth 12%.

Sipas MIE-s, në vitin 2021, në Shqipëri ka 19 operatorë ajrorë, kundrejt vitit 2019, në të cilin kanë ushtruar aktivitetin 17 operatorë ajrorë. Sipas MIE-s, heqja e tarifës aktuale, do të ketë një impakt domethënës në uljen e çmimit të biletave, duke ndikuar pozitivisht tek operatorët për të rritur numrit e destinacioneve të fluturimeve nga aeroporti, në përputhje me objektivat e Strategjisë së Aviacionit Civil. Gjatë vitit 2019 në aeroportin e TIA-s janë regjistruar rreth 3,338,147 pasagjerë, ndërkohë që në vitin 2021 ky numër arriti në 2,923,533 pasagjerë. Vlerësohet se ulja e çmimit të biletave, si pasojë e heqjes së tarifës aktuale, do të rrisë edhe më shumë aksesin në aviacion dhe parashikimi i pasagjerëve, vetëm gjatë 2022, pritet të arrijë në 4 milionë pasagjerë. Heqja e kësaj tarife do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e trafikut ajror, numrit të linjave ajrore, destinacioneve të reja dhe numrit të pasagjerëve edhe në infrastrukturën e reja aeroportuale, siç është Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës.

Në këto kushte, Komisioni vlerëson se plani i njoftuar është ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

14. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se masa lidhet me një “ndihmë me karakter social, që iu jepet konsumatorëve individualë” dhe, për këtë arsye, është në përputhje me dispozitat e shkronjës “a”, të nenit 7, të ligjit nr. 9374, datë 25.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, i cili parashikon, se: “ndihma me karakter social, që jepet për individë, nëse kjo ndihmë është dhënë pa krijuar diskriminim lidhur me origjinën e produkteve në fjalë”, është një ndihmë shtetërore e lejueshme.

15. Komisioni konstaton se eliminimi i tarifës është në dobi të konsumatorëve fundorë/pasagjerët e transportit ajror. Heqja e tarifës pritet të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e trafikut ajror, numrin e linjave ajrore, destinacioneve të reja, numrin e pasagjerëve, si edhe në infrastrukturën e reja aeroportuale, si Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës. Kompanitë e transportit ajror aplikojnë tarifën në çmimin e biletës së fluturimit të pasagjerit. Në këtë mënyrë, eliminimi i tarifës do t’u mundësojë pasagjerëve lirimin nga pagesa e kësaj tarife. Kompanitë ajrore duhet të tregojnë dukshëm çmimin e biletës, si edhe tarifën e detajuar. Pra, masa është e projektuar për t’i lejuar konsumatorët që të udhëtojnë në mënyrë ekonomike nga dhe drejt Shqipërisë.

16. Sipas studimeve të *Oxford-it*³, përmirësimet në konektivitetin ajror ndikojnë në zhvillimin ekonomik, nëpërmjet rritjes së produktivitetit. Rritja e produktivitetit në bizneset jashtë industrisë së shërbimit të aviacionit është rrjedhojë e dy burimeve kryesore: rritjes së aksesit të biznesit vendës në tregjet e huaja dhe rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve të huaja në tregun vendës, si edhe nëpërmjet lëvizjes së lirë të kapitalit investues dhe fuqisë punëtore ndërmjet vendeve.

17. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, shpenzimet nga turistët e huaj, në periudhën 2015–2019 kanë një rritje të ndjeshme në vlerë absolute, por edhe në raport me PBB-në, ku në vitin 2019 shpenzimet e turistëve të huaj përbëjnë 15.1%. Ndërkohë, në vitin 2021, ecuria e shpenzimeve është pozitive krahasuar me vitin 2020, për shkak të COVID-19, duke u rritur në 12.4% të PBB-së.

³ Oxford Economics, November 2014.

Tabela 2: Eksportet e shërbimeve të udhëtimit, si përafrues i treguesit për të ardhurat nga turistët e huaj
(të dhëna që burojnë nga statistikat e bilancit të pagesave), të shprehura në milionë euro dhe si raport ndaj PBB-së

Treguesit	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Exp, shërbime udhëtimi (milionë euro)	1352.4	1527.9	1707.6	1856.7	2083.3	988.2	1912.3
Raport ndaj PBB-së (%)	13.2	14.3	14.8	14.5	15.1	7.4	12.4

Burimi: Banka e Shqipërisë

Sa më lart, Komisioni vlerëson, se plani i ndihmës shtetërore është i lejueshëm në përputhje me nenet 4 dhe 7, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 7, 17, 22 dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore nëpërmjet eliminimit të tarifës së shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, të parashikuar në udhëzimin nr. 1917, datë 1.9.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”.

2. Ministria përgjegjëse për zhvillimin e transportit ajror, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për monitorimin e impaktit të ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar me informacion të detajuar mbi efektin e eliminimit të tarifës së shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë në çmimin e biletave për pasagjerët, rritjen e turistëve të huaj, të ardhurat shtesë në buxhetin e shtetit.

3. Të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës të ruhen deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

4. Ky vendim të botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Delina Ibrahimaj